

REPUBLICA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA/VLADA-GOVERNMENT
MINISTRIA E PUNES DHE MIREQENIES SOCIALE
Ministarsivo Rada i Socialne Zashite-Ministry of Labour and Social Welfare
TRUPA EKZEKUTIVE E INSPEKTORIATIT TE PUNES
Izvrshni Organ Inspekcije Rada-The Executive Body of Labour Inspectorate

ajoni:
egjion: FERIZAJ
r. i faqeve
r. stranica
o. pages 04

Nr. Prot:
Broj Prot: 355/23
Prot. No:
Data:
Datum: 08/08/2023
Date:



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Qeveria / Vlada / Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera
Ministry of Finance, Labour and Transfers
Inspektorati i Punës/Inspektorata Rada/Labour Inspectorate

Inspektorati i Punës në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve, Inspektorja e Punës Afërditë Metushi Berisha me ID.1268, duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 1, 2 dhe 5 të Ligjit mbi Inspektoratin e Punës 2002/9, dispozitave të Ligjit Nr.03/L-017 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Inspektoratit të Punës Nr.2002/9, nenit 2 paragrafi 1 dhe 2, nenit 92 paragrafi 1, dhe nenit 94 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, nenit 2, 24 dhe 25 të Ligjit Nr.04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, nenit 44,47 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke vendosur për lëndën e punëdhënësit QKMF - "Dr.Vezir Bajrami", Shtime bie këtë:

VENDIM

Për shqiptimin e masës ndëshkimore

Subjekti QKMF - "Dr.Vezir Bajrami", me seli në Shtime rruga "Anton Çeta" me punëshënës: Dr.Pranvera Bajrami, tekstin në vijim punëdhënësi/ja është përgjegjës/se për:

- **Mos zbatimin e dispozitav ligjore** të nenev 8, 10,11 dhe 17 paragrafi 1 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 të sanksionuar me nenin 92 paragrafi 1 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dhe nenit 7 paragrafi 4 nënparagrafi 4.2, paragrafi 2 nënparagrafi 2.2, paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, paragrafi 2 nënparagrafi 2.7 i Udhëzimit Administrativ Nr.07/2012 për Përcaktimin e Gjobave dhe Shumave Konkrete për shkelje të dispozitave të Ligjit Nr.03/L-212 i Punës, i shqiptohet gjobë në lartësi prej **Pesëqind Euro (500 €)**

Gjithsej i shqiptohet gjobë në lartësi prej Pesëqind Euro (500 €)

Punëdhënësi QKMF-"Dr.Vezir Bajrami", në Shtime është i obliguar që pagesën e dënimit ta bëjë në afat prej tetë (8) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi në xhirollogarinë 1000430070006532 në emër të IP.

Dëftesa mbi pagimin e dënimit merret te Inspektorët e Punës në Ferizaj

Punëdhënësi QKMF-"Dr.Vezir Bajrami", në Shtime, duhet të dëshmoj pagesën e dënimit, duke dorëzuar një kopje të pagesës te Inspektorët e Punës, në të kundërtën do konsiderohet

se nuk është bërë pagesa dhe do inicihet procedura përmbarese e iniciimit me dhunë tek organet kompetente.

Në bazë të nenit 6.4 të Ligjit Nr.2002/9 dhe nr.03/L-17 për Inspektoratin e Punës në Kosovë, Ankesa e ushtruar në Vendimin e Inspektoratit të Punës, nuk e shtyn ekzekutimin e këtij vendimi

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës Rrahman Jakupi, me datë 24.05.2023, në Inspektoratin e Punës Rajonin e Ferizajt ka dërguar ankesën përmes mjeteve elektronike-në emailin zyrtar tek Kordinatori Z.Arton Çerkini, me pretendimet se: në QKMF "Dr.Vezir Bajrami" në Shtime, Drejtoresha Pranvera Bajrami ushtron pozitën e drejtorit pa përfillur dhe pa zbatuar procedurat e konkursit, pastaj pozitën udhëheqëse në këtë institucion ndryshohen me vendim nga drejtoresha Pranvera Bajrami pa përfillur kontratat e punës për të punësuarit Musë Baftiu-kryeinfermier I QKMF-së, Fahrije Maksuti-kryeinfermiere e shërbimit të Mjekësisë Familjare, Behxhet Hyseni-kryeinfermier i shërbimit të urgjencës, Osman Ismajli kordinatorë i SISH, dhe punësimi pa përfillur procedurat ligjore, Efendi Sahiti dhe Beqir Beqa.

Inspektorja e Punës duke vepruar sipas ankesës Nr.38/23 të pranuar me datë 25.05.2023, të ushtruar nga parashtruesi Rrahman Jakupi për vërtetësinë e pretendimeve ankimore me datë 09.06.2023, rreth orës 09:45h, bënë vizitë inspektuese dhe takohet me Kaltrina Beqa-zyrtare për personel në administratë, ku e njoftojmë me pretendimet ankimore të palës ankuese dhe obligon, të prezantoj dokumentacionin si në vijim:

- Konkursin publik për drejtorë –Pranvera Rexhepin.
- Kontratat e punës për kryeinfermierët, Musë Baftiu, Fahrije Maksuti, Behxhet Hyseni dhe Osman Ismajli.
- Vendimet e emrimit të zyrtarëve në pozitën udhëheqëse, konkursin publik dhe kontratat e punës.
- Themelimin e marrëdhënies së punës për mjekët specialist dhe konkursin publik për Beqir Beqa dhe Efendi Sahiti.
- Kontratën Nr.03/1/014 datës 20.04.2021.
- Listen e pagave për të punësuarit Musë Baftiu, Fahrije Maksuti, Behxhet Hyseni, Osman Ismajli për muajt tetorë, nëntorë 22 dhe muajt prill, maj 2023.

Inspektorja e Punës pas prezentimit të provave nga punëdhënësi dhe shqyrtimit të tyre ka hartuar Raport Zyrtar Nr.294/23 me datë 07.07.2023 konstatoi se:

-Punëdhënësi QKMF "Dr.Vezir Bajrami" në Shtime, ka të punësuar Dr.Pranvera Bajrami në pozitën e drejtorit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare "Dr.Vezir Bajrami" në Shtime, është emruar vetëm me Vendimin Nr.02/02 të datës 11.01.2022, sipas të cilit vendim znj.Pranvera Bajrami caktohet Ushtrues i Detyrës Drejtor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare "Dr.Vezir Bajrami" në Shtime, dhe në këtë rast punëdhënësi QKMF-Shtime nuk ka përfillë procedurën e themelimit të marrëdhënies së punës për drejtor të QKMF-së në Shtime, pra nuk ka zbatuar dispozitën ligjore të nenit 8 të Ligjit të Punës

Nr.03/L-212, sipas të cilit cillon: punëdhënësi në sektorin publik, është i obliguar që të shpall konkurs publik kur pranon një punëmarrës dhe themelon një marrëdhënie të punës,

-Sipas vendimit nr.128 datës 04.04.2022 të punësuarit Musë Baftiu i ndrrohet vendi punës nga pozita që kishte me kontratë pune për kohë të pacaktuar nr.70/2013 datë 25.01.2013, Kryeinfermier i QKMF-së, në vendin e punës Infermier në Mjekësinë Familjare në QKM-Shtime, pastaj të punësuares Fahrije Maksuti me vendimin nr.106 datë 21.03.2021 i ndrrohet vendi i punës nga pozita që kishte me kontratë pune për kohë të pacaktuar nr.376 datë 30.10.2019, Kryeinfermiere e shërbimit të mjekësisë familjare në kohë të pacaktuar në QKMF-Shtime, në vendin e punës infermiere në MF-QKMF në Shtime, të punësuarit Behxhet Hyseni me vendimin nr.126 datës 04.04.2022, i ndrrohet vendi i punës nga pozita që kishte sipas kontratës së punës për kohë të pacaktuar nr.377 datë 30.10.2019, Kryeinfermier i njësisë urgjente në kohë të pacaktuar në pozitën Infermier në mjekësinë familjare (në protokolim) në QKMF-Shtime, si dhe të punësuarin Osman Ismajli sipas vendimit nr.127 datës 04.04.2022, i ndrrohet vendi i punës nga Kryeinfermier i mjekësisë urgjente që kishte nga data 25.01.2013 me Kontratë pune për kohë të pacaktuar në pozitën Infermier në mjekësinë familjare në QKMF-Shtime, dhe të njëjtat pozita i zëvendëson me të punësuarit: Sahadete Sopa e cila caktohet ushtrues i detyrës së Kryeinfermierit në QKMF-Shtime, Fikrije Xhelili caktohet ushtrues i detyrës në pozitën Koordinatorë i Sistemit informativ Shëndetësorë, Isuf Abazi caktohet ushtrues i detyrës në pozitën Kryeinfermier në Mjekësinë Familjare QKMF-së Shtime, Mervete Hasani caktohet ushtrues i detyrës në pozitën Kryeinfermier në Urgjencë në QKMF-Shtime, pa përfillur procedurat ligjore sipas nenit 4 paragrafi 6 të Udhzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, dhe duke mos zbatuar kontratat e punës për të punësuarit e lartcekur të cilat janë për kohë të pacaktuar, të cilat kontrata janë të firmosura nga punëdhënësi dhe të punësuarit, në këtë rast punëdhënësi bënë shkelje të nenin 17 paragrafi 1 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, sipas të cilit nen i punësuarit caktohet në vendin e punës për të cilin ka lidhur Kontratë Pune, sipas dëshmisë së pagav mujore të prezentuar nga punëdhënësi të punësuarit: Musë Baftiu, Osman Ismajli, Behxhet Hyseni dhe Fahrije Maksuti, me ndrrimin e pozitav iu ndryshohet edhe paga mujore prove: pagat mujore për muajin tetor, nëntor 2022, nuk janë të njëjta me muajt prill, maj 2023 me të cilën vërtetohet se të punësuarit me ndrrimin e pozitav pa përfillur procedurat ligjore iu është ndryshuar dhe pagesa e pagav mujore.

-Punëdhënësi QKMF "Dr.Vezir Bajrami" në Shtime, nuk prezentoji dëshminë si janë të punësuar mjekët specialist Dr, Beqir Beqa dhe Dr. Efendi Sahiti, apo janë të angazhuar përmes Kontratës Publike Kornizë 24 Mujore Nr.03.01.014 të Lidhur me datë 20.04.2021 ndërmjet "Caritas Kosova" dhe Komuna Shtime, për shërbime shëndetësore shtëpiake-paliative dhe shërbimet sociale e rezidenciale për personat në nevojë në Komunën e Shtimës-Kontratë kornizë për 24 me numër 617-21-905-2-1-1, e cila kontratë nuk përmbanë pozitat të cilat i ushtrojnë mjekët e lartcekur, dhe në këtë rast punëdhënësi ka bër shkelje të nenit 10 nenin 11 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, sipas të cilit kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuarit dhe kontrata duhet të përfshin elementet e përcaktuara sipas nenit 11 të këtij ligji.

Pala ankoese Rrahman Jakupi me datë 17.07.2023, bënë vrejte ndaj raportit zyrtar sipas të cilit nuk është konstatuar pretendimi lidhur me pikën 2 të ankesës Shefit të Shërbimit të Mjekësisë Familjare në QKMF-Shtëme Dr. Ilaz Kadrija specializant i Mjekësisë Familjare i cili ushtron detyrën si ushtrues mbi një vit pa procedure të rregullt për rekrutim, andaj pas analizimit të vërejtjes ndaj raportit vërtetohet se punëdhënësi QKMF "Dr. Vezir Bajrami" në Shtëme, nuk ka zbatuar dispozitën ligjore të nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-202, dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe 6 të Udhzimit administrative (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, i cili duhet të shpallë konkurs publik (ose të brendshëm) për plotësimin e vendit të Shefit të Shërbimit të Mjekësisë Familjare në QKMF-Shtëme.

Me datë 28.07.2023 Zyrtarja për personel dhe administratë Znj. Kaltrina Beqa me datë 28.07.2023 dërgon përmes emailit zyrtar tek Koordinatori z. Arton Çerkini përgjigje ndaj Raportit Zyrtar Nr.294/23 datës 07.07.2023, lidhur me ankesën nr.38/23.

Ankesa e datë 24.05.2023, e parashtruar nga ankuesi Rrahman Jakupi përmes mjeteve elektronike- emailit, është e hazuar.

Punëdhënësit, i bëhet me dije se edhe pas pranimi të këtij vendimi nuk lirohet nga përgjegjësia e mos zbatimit të dispozitës ligjore në fjalë.

Andaj në bazë të asaj që u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ankesa Nr.38/23 datë 25.05.2023, Raporti Zyrtar inspektues Nr.261/23 i datës 09.06.2023, Raporti Zyrtar Nr.294/23 i datës 07.07.2023, Vërejtja e datës 17.07.2023 e ushtruar nga Z. Rrahman Jakupi dhe Vërejtja e datës 28.07.2023 e ushtruar nga zyrtarja për personel dhe administratë Znj. Kaltrina Beqa, dhe i gjithë dokumentacioni i rastit, konsiderohen pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe gjenden në dosjen e rastit.

Datë: 08.08.2023



Inspektore e Punës

Këshilla juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të parashtojë ankesë Inspektoratit të Punës pranë MFPT në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimi të këtij Vendimi. Ankesa ushtrohet përmes Inspektorëve të Punës në Ferizaj rruga "Vëllezërit Çetvalla" Administrata Pensionale e Kosovës, kati III zyrja nr.5.